



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 7252/2 prot.

Tiranë, më 18.11.2019

VENDIM

Nr. 66, datë 18.11.2019

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DISIPLINORE TË
KËSHILLTARËVE TË NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR TË KOMISIONIT TË
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”

Në mbështetje të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Rregulloreve të veprimtarisë së Komisionit, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.07.2017, në mbledhjen e datës 18.11.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregulloreve “Për procedurat disiplinore të këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Publikimin e kësaj rregulloreje në faqen zyrtare të Komisionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

